

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Policia austriake forcon sigurinë para sfidës me Kosovën, vendosen masa të posaçme për tifozët
ADRESA	https://albeu.com/sport/policia-austriake-forcon-sigurine-para-sfides-me-kosoven-vendose-n-masa-te-posacme-per-tifozet/1028449/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 13:09:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 13:03:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	28751fe395487ac604f2ddbd22beaf27f2ab63c88b783ee11edfe68ff5db178e
TEKSTI	c0db714d35b7b5a73f431d0a405dd263517b3b49e3fa68abb348ec5f0b415c55
PAMJA	befbfdfaa02d5905d7ef0e7de473fee4da16913509e4320d5d7e81477a392f610

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e94106e828dde96b04e57d94bbcd5f925662f84b7dd6abdabf4f16621bf52495
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7a6930be9f3749f4980fd84dca137394dacb19a29045da8941f5e341c088ecc2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e94106e828dde96b04e57d94bbcd5f925662f84b7dd6abdabf4f16621bf52495>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Policia austriake forcon sigurinë para sfidës me Kosovën, vendosen masa të posaçme për tifozët



Të dielën, në Vjenë, do të aplikohen masa të zgjeruara sigurie përpara përballjes së Ligës së Kombeve mes Austrisë dhe Kosovës, e planifikuar të zhvillohet në stadiumin "Ernst Happel".

Sipas mediumit austriak *5 Minuten*, Drejtoria e Policisë së Vjenës ka përcaktuar një zonë të gjerë sigurie rreth stadiumit, e cila do të jetë aktive nga ora 10:00 deri në 22:00. Për shkak të kontrolleve të imtësishme, tifozëve u është kërkuar të llogarisin kohë shtesë për të hyrë në stadium.

Hapësira e kufizuar nuk përfshin vetëm zonën pranë "Ernst Happel", por shtrihet edhe në Krieau, Olympiaplatz, Stadioncenter, zonën e Stadionbad dhe Hauptallee. Gjatë kësaj periudhe, policia do të mund të largojë dhe t'u ndalojë hyrjen në zonë personave që dyshohen se mund të përfshihen në veprime të dhunshme.

Shkelja e ndalimit të hyrjes dënohet me gjobë deri në 1,000 euro. Në rast përsëritjeje, masa financiare mund të shkojë deri në 4,600 euro, ndërsa për personat që nuk kanë mundësi ta paguajnë gjobën parashikohet burgim zëvendësues deri në katër javë.

Kontrolle të forta do të kryhen edhe në portat hyrëse të stadiumit. Tifozët do t'i nënshtrohen kontrollit të veshjeve dhe çantave, ndërsa mospranimi i procedurës do të sjellë përjashtimin nga stadiumi. Sipas raportimit, nëse rrethanat e kërkojnë, ky përjashtim mund të realizohet edhe me forcë.

Mbajtësit e biletave duhet të kenë parasysh se personat të cilëve u mohohet hyrja për shkak të refuzimit të kontrollit nuk do të përfitojnë kompensim për çmimin e biletës nga qeveria federale.

Austria dhe Kosova do të përballen të dielën, më 27 shtator, në stadiumin "Ernst Happel". Takimi nis në orën 19:00.

të fundit /



Tragjedi për familjen shqiptare, motër e vëlla mes viktimitave në...



Donika Gërvalla i përgjigjet kërkesës për dorëheqje dhe akuza...



Gërvalla: Qeveria po përgatitet për fazën e ardhshme të betejës...



Gërvalla: Byroja do të verifikojë pasurinë e pajustifikueshme...



Projekti italian e kthen BMW M2 në homazh të 3.0 CSL të viteve '70



Gërvalla: Projektligji i PDK-së po shqyrtohet me kujdes, opinioni d...



Dua Lipa shfaqet papritur në një dasmë familjare në Pejë



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Shtuar më 26.09.2026 15:03

Tags: [Kombëtarja e austrisë](#), [Kombëtarja e kosovës](#),
[Liga e Kombeve](#)



Irlanda anulon paraqitjen mediatike para ndeshjes me Izraelin, shtohen...



Erblin Osmani shkruan historinë me Kosovën, debutimi i 17-vjeçarit...



Zidane rikthen Mbappen në krah, ylli francez i pakënaqur me rolin e ri



Ernest Muçi është ylli i ri i Shqipërisë, vendimi i fundit konfirmon se do jetë ai n...



Dardanët" mbyllin përgatitjet në Kosovë para përballjes me Austrinë



Debutimi historik i Erblin Osmanit me Kosovën bëhet lajm në mediat gjermane



Përrjashtimi me karton të kuq shkaktoi përleshje masive në përfundim të...



Çështja "Xhaka" merr përmasa të reja, mesfushori shqiptar...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.